

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN – Departamenti për Krime të Rënda, trupi gjykues në përbërje nga gjyqtarët, Xhevdet Elshani kryetar, Nazim Vllaqo e Fatmir Krasniqi anëtar, me bashkëpunëtorin profesional Shahadin Destani, në lëndën penale kundër të akuzuarve; A.H. nga Prizreni për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprat penale; vrasje në tentativë, nga neni 178 lidhur me nenin 28 të KP-së dhe veprës penale, mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armeve nga neni 374 par. 1 të KP-së dhe të akuzuarit A.H.1, nga Prizreni, për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprat penale; mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armeve nga neni 374 par. 1 të KP-së dhe veprës penale lajmërimi apo kallëzimi i rremë, nga neni 390 par. 3 të KP-së, të akuzuar nga Prokuroria Themelore në Prizren DKR, sipas aktakuzës, PP.nr.332/15, e datës 22.03.2016, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe seancës së pleqërimit dhe votimit në të njëjtën ditë, në prezencën e të akuzuarve, Prokurorit të Shtetit Sefer Morina dhe mbrojtësit të të akuzuarit A.H. av. B.N. , me datë 14.12.2016, merr dhe publikisht shpall këtë:

A K T G J Y K I M**Të akuzuarit:**

A.H. , nga i ati S. dhe e ëma L. me mbiemër të vajzërisë K. , i lindur me datë “data e lindjes..”, në Prizren, ku edhe tani jeton, rr. “.....”, nr. .. , me profesion autolimar, ka të përfunduar shkollën e mesme, i pamartuar, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, gjendet në paraburgim nga data 16.02.2016 i cili vazhdon deri në plotfuqishmëri të këtij aktgjykimi.

A.H.1 , nga i ati S. dhe e ëma L. me mbiemër të vajzërisë K. , i lindur me datë “data e lindjes..”, në Prizren, ku edhe tani jeton, rr. “.....”, nr. .. , punëtor, ka të përfunduar shkollën e mesme, i pamartuar, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka qenë në paraburgim nga data 09.12.2015 deri me datë 16.02.2016 dhe në arrest shtëpiak nga data 16.02.2016 deri me datë 02.03.2016.

I. I akuzuari **A.H.** ,

ËSHTË FAJTOR

1. Se me datë 05.12.2015, rreth orës 19:45 min, në Prizren, në rrugën “.....”, me dashje eventuale, ndërmerr veprim të drejtpërdrejt, tenton ta privoj nga jeta K.B. , në atë mënyrë që si pasojë e një mosmarrëveshje të mëhershme të cilën e kishin ndërmjet vete, së bashku me vëllain e tij A.H.1 , hyjnë në lokalin e fitnesit “.....”, që gjenet afër pompës së derivateve “... –” dhe pasi e vërejnë të dëmtuarin brenda duke bërë ushtrime në vegla, shtënë me armë zjarri – pistoletën e tipit “Ekol Tuna - Zastava”, të kalibrit 8mm, një herë në drejtim të tij, nga një distancë prej 4,40 metra, të cilin e godet në krahun e djathtë – bërryl, me ç’rast i shkaktonte plagë hyrëse nga depërtimi i predhës së plumbit në krahë, duke i shkaktuar lëndime të rënda trupore.

- Me këto veprime kryen veprën penale, vrasje në tentativë, nga neni 178 lidhur me nenin 28 dhe nenin 21 paragrafi 3, të KP-së.

2. Se prej kohës së pa vërtetuar deri me datë, 05.12.2014, në Prizren, mbanë në posedim armën e zjarrit pistoletën e tipit “Ekol Tuna - Zastava”, të kalibrit 8mm, Gas, me nr. serik ET1021714, e dizajnuar edhe për fishek të kalibrit 6.35x15mm, pa autorizim dhe pa leje të organit kompetent, të cilën armë edhe e ka përdorur duke shtënë në të dëmtuarin sikurse në dispozitivin nën 1 të këtij aktgjykimi .

- Me këto veprime kryen veprën penale, mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar e armeve nga neni 374 par 1, të KP-së.

Prandaj Gjykata në pajtim me nenet, 4, 41, 43, 45, 62, 73, 74, 75, 80, 83, nenit 178 lidhur me nenin 28 dhe nenit 374 par. 1, të KP-së si dhe nenit 365 të KPP-së, të akuzuarin **A.H.** :

1. Për veprën penale, vrasje në tentativë, nga neni 178 lidhur me nenin 28, të KP-së i shqipton;

Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti e 6 (gjashtë) muaj.

- Për veprën penale, mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar e armeve nga neni 374 par 1, të KP-së i shqipton;

Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muaj.

Në kuptim të nenit 80 dhe nenit 83 të KP-së të akuzuarin A.H. e,

G J Y K O N

Me dënim unik burgimi në kohëzgjatje prej 1 (një) viti e 8 (tetë) muajve, në të cilin dënim do të llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 16.02.2016 deri me datë 13.07.2016, arresti shtëpiak nga data 14.07.2016 deri me datë 30.10.2016 si dhe paraburgimi i ri caktuar nga data 31.10.2016 e cila masë vazhdon deri në plotfuqishmërinë e këtij aktgjykimi.

3. Po ashtu ndaj të akuzuarit A.H. shqiptohet edhe,

DËNIMI PLOTËSUES

Ashtu që prej tij merret arma e tipit “Ekol Tuna - Zastava”, të kalibrit 8mm, Gas, me nr. serik ET1021714, si mjet i kryerjes së veprës penale.

II. I akuzuari, A.H.1 ,

Në mbështetje të nenit 364, paragrafi 1 pika 1.3 të Kodit të Procedurës Penale

LIROHET NGA AKUZA

1. Se prej datës së pa vërtetuar deri me datë, 09.12.2014, në Prizren, gjatë një kontrolli nga ana e policisë tek i akuzuari haset duke e mbajtur në posedim dhe kontroll armën e zjarrit pistoletën e tipit “Ekol Tuna - Zastava”, të kalibrit 8mm, Gas, me nr. serik ET1021714, e dizajnuar edhe për fishek të kalibrit 6.35x15mm, pa autorizim dhe pa leje të organit kompetent,

me të cilat veprime kishte për të kryer veprën penale, mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar e armeve nga neni 374 par 1, të KP-së.

- **në mungesë të provave**

Ndërkaq,

ËSHTË FAJTOR

2. Se me datë 05.12.2015, në Prizren, pas informatës të cilën e kishin pranuar Policia se ka ndodhur një rast i plagosjes me armë zjarri në rr. “.....”, saktësisht në klubin e fitnesit “.....” nga ana e personave të panjohur për policinë, i akuzuari A.H.1 paraqitet në polici dhe lajmëron se ai e ka kryer veprën penale të plagosjes me armë, me ç’ rast thotë se vetë ka shtënë në të dëmtuarin K.B., i cili po ashtu rrejshëm ka deklaruar edhe në Prokurori, derisa gjatë hetimeve të kryera është zbuluar se ai nuk është kryerës i kësaj vepre por vëllai i tij – akuzuari A.H. .

- Me këto veprime kryen veprën penale, lajmërimi apo kallëzimi i rremë, nga neni 390 par. 3 të KP-së.

Prandaj gjykata në pajtim me nenet, 4, 41, 43, 45, 62, 73, 74, 75, nenit 390 par. 3, të KP-së si dhe nenit 365 të KPP-së, të akuzuarin A.H.1 për veprën penale, lajmërimi apo kallëzimi i rremë, nga neni 390 par. 3 të KP-së e,

G J Y K O N

Me dënim me burgim, në kohëzgjatje prej 2 (dy) muajve, në të cilin dënim do të llogaritet koha e kaluar në paraburgim 09.12.2015 deri me datë 16.02.2016 dhe në arrest shtëpiak nga data 17.02.2016 deri me datë 02.03.2016.

I dëmtuari K.B. udhëzohet që kërkesën pasurore – juridike ta realizoj në kontest të rregullt juridio – civil.

Obligohen të akuzuarit A.H. dhe A.H.1 që t’i paguajë shpenzimet e procedurës dhe atë në emër të paushallit gjyqësor në mënyrë solidare shumë prej 200 Euro, të cilat do t’i paguajnë në afat prej 30 dite, prej ditës së plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën ekzekutim të përmbarimit ligjor.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren, Departamenti për Krime të Rënda, ka parashtruar aktakuzën PP.nr.332/15, e datës 22.03.2016, kundër A.H. nga Prizreni për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprat penale; vrasje në tentativë, nga neni 178 lidhur me nenin 28 të KP-së dhe veprës penale, mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armeve nga neni 374 par. 1 të KP-së dhe A.H.1 , nga Prizreni, për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprat penale; mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armeve nga neni 374 par. 1 të KP-së dhe veprën penale lajmërimi apo kallëzimi i rremë, nga neni 390 par. 3 të KP-së.

Prokurori i Shtetit gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare ka theksuar se qëndron në tërësi pranë aktakuzës, se të akuzuarit A.H. dhe A.H.1 kanë kryer veprat penale me të cilat ngarkohen në aktakuzë, pasi që nga të gjitha seancat e mbajtura gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor, nga provat materiale të administruara, të cilat i ka përmbajtur aktakuza si dhe provave të nxjerra dhe siguruara nga ana e gjykatës gjatë shqyrtimit gjyqësor e veçmas nga raporti i rikonstruimit të vendit të ngjarjes, dëshmisë të eksperteve të balistikës dhe atij mjeko – ligjor, dëshmime të dëshmitarëve si dhe deklaratat e të akuzuarve të dhënë në mbrojtjen e tyre të cilët pjesërisht i kanë pranuar veprimet e tyre, konsideron se në mënyrë të plotë dhe të padyshimt në tërësi është vërtetuar gjendja faktike e përshkruar si në aktakuzë dhe se të akuzuarit në veprimet e tyre janë kryes të këtyre veprave penale për të cilat ngarkohen nga aktakuza, prandaj i ka propozuar gjykatës që të akuzuarit pas administrimit të provave për këto vepra të shpallën fajtor dhe tu shqiptohet dënimi i paraparë sipas ligjit duke i vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese sipas dispozitave të KPP-së.

I akuzuari A.H. , në mbrojtjen e tij ka deklaruar se, në ditën kritike së bashku me vëllain e tij A.H.1 kanë shkuar në fitnesin “.....” për tu regjistruar ku i janë drejtuar banakut për ta kërkuar personin kompetent për regjistrim. Me tej i njëjti ka deklaruar se nuk e ka ditur që i dëmtuari K.B. gjendet në këtë lokal dhe në momentin derisa ishin afër banakut të akuzuarit A.H. dhe A.H.1 , kanë vërejtur se aty afër ka qenë i dëmtuari K.B. , ku i njëjti pas ballafaqimit me të akuzuarit ka filluar t’i sulmoj ata me tega (mjete për ushtrime) si dhe i ka ofenduar duke ia sharë robt, në atë moment i akuzuari A.H.1 ka marr një shtagë beisbolli para derës së fitnesit mirëpo nuk kanë mundur ta sulmojnë të dëmtuarin K.B. pasi që i njëjti ka qenë me vëllain dhe ka pasur një hekur të rëndë në dorë. Ka deklaruar se është e vërtet se në ditën kritike ka pasur pistoletën e adoptuar me pesë fishekë e cila i ka qëlluar rastësisht me vete dhe në momentin e acarimit të situatës ka shtënë një herë në drejtim të dëmtuarit K.B. i cili ishte duke ecur në drejtim të tij në distancë prej 3 – 4 metra, mirëpo, nuk ka pasur qëllimin që ta vret të dëmtuarin por, vetëm ta frikësoj, ta ndal pasi që situata ishte acaruar dhe se fillimisht ka menduar se nuk e ka goditur. Më pas i dëmtuari K.B. është larguar dhe ka hyrë në zhveshtore ku e ka mbyllur derën ku pas kësaj me insistimin e pronarit të lokalit të akuzuarit A.H. dhe A.H.1 kanë dalur jashtë. I akuzuari në fjalën përfundimtare ka deklaruar se, i vjen keq që ka ndodhur ky rast, është penduar, dhe nuk do të përsërit një veprim të tillë në të ardhmen, thekson se kanë qenë në rrethana të tilla të cilat ia ka shpjeguar gjykatës. Ka lutur gjykatën që të ketë parasysh të gjitha rrethanat e tija familjare, moshën me rastin e gjetjes eventuale si fajtor të veprimeve të tija që të shqiptoj një dënim sa më të butë, me që edhe paraburgimi por edhe shqyrtimi gjyqësor i deri tanishëm konsideron se kanë mjaftuar që i njëjti të ketë tërësisht qëndrim të ri lidhur me situatën dhe rrethanat në të cilat ka kryer veprën penale për të cilën është ngarkuar sipas aktakuzës.

I akuzuari A.H.1 në mbrojtjen e tij të cilën e ka paraqitur personalisht, ka deklaruar se, është e vërtet se në polici ka pranuar veprën penale për të cilën tani akuzohet vëllai i tij A.H. dhe se ka shtënë në të dëmtuarin K.B. mirëpo, thotë se këtë e ka bërë për të mos e ngarkuar vëllain, ndërsa në të vërtetë nuk ka gjuajtur me armë dhe se armën më herët nuk e ka poseduar asnjëherë, përveç rastit kur e ka dorëzuar në polici. I njëjti ka sqaruar për faktin se në ditën kritike kanë shkuar së bashku me vëllain e tij A.H. në fitnes për tu regjistruar dhe me tu takuar me të dëmtuarin K.B. në këtë lokal të fitnesit i dëmtuari ka filluar ta shaj dhe ka kapur një tegë në dorë për ta sulmuar. I akuzuari A.H.1 thekson se ka dalur jashtë ka marr një dërrasë ndërkaq, në këtë kohë ka hyrë A.H., të cilit i ka treguar se K.B. po e Sulmon, A.H. ka vazhduar rrugën drejtë banakut ndërsa A.H.1 ka hyrë me dërrasë në dorë duke dashur që t’i thotë K.B. se perse e ka shajtur, ndërkaq arma ka shkrepur kur i akuzuari A.H. ka hyrë në lokal për herën e dytë. I njëjti

në fjalën përfundimtare ka sqaruar se, revolen e vëllait të cilën më parë asnjë herë nuk ka pas në posedim ka dashur që të ia dorëzoj policisë, ndërkaq e ka pranuar veprën si të tijën edhe pse e ka ditur se atë veprim e ka kryer vëllai me që në polici ishte marr në pyetje si i dyshuar prandaj në atë moment nuk ka dashur që ta komplikoj situatën dhe ka vendosur që ta inkriminoj veten. Në përfundim ka kërkuar nga trupi gjykues që të kenë parasysh këto veprime të tija të pa menduar mirë në kohën kur i ka ndërmarr dhe nuk ka menduar për pasojat që do t'i ketë në të ardhmen, ka lutur gjykatën që t'i ketë këto rrethana dhe ndaj tij të merr një vendim adekuat në kuadër të dispozitave ligjore sa më të përshtatshëm e në rase e gjen përgjegjës një dënim sa më të butë.

Mbrojtësi i të akuzuarit A.H.– avokati B.N. , ka deklaruar se konstatimi i paraqitur nga ana e përfaqësuesit të aktakuzës se të pandehurit pjesërisht kanë pranuar veprimet e tyre duhet të plotësohet me atë se ata në fakt plotësisht kanë pranuar veprimet e tyre. Gjithashtu më duhet të theksoj se të gjitha provat të cilat janë administruar në një mënyrë kanë dhënë mundësi e konkludimit se çfarë dhe si kanë qenë veprimet në rastin konkret. Fatkeqësisht më duhet të theksoj se aktakuza përkatësisht tërë procedura në këtë çështje penale në drejtim të pretendimit për veprën penale nga neni 178 lidhur me nenin 28 të KP-ës ka mbet e mangët nga se për të ekzistuar kjo vepër penale pra vrasje në tentativë doemos akuza duhet të vërtetohet pa asnjë mëdyshje se në anën e kryesit të veprës penale ka dashje në këtë drejtim mungon një vërtetim i tillë. Këtë them se nga provat e administruara sidomos nga rekonstruimi i vendit gjatë së cilës janë përcaktuar më saktësisht pozitat e artereve është vërtetë se i akuzuari A.H. me rastin e përdorimit të armës këtë e ka bërë me hamendje dhe me gjasa për shkak të frikës në anën e tij për mundësi e veprimit nga ana e të dëmtuarit. Pra nëse kihet parasysh edhe fakti se ai ka pasur edhe predha tjera të cilët nuk i ka përdorur me doemos duhet konkluduar se mungon elementi i dashjes nga se sikur të kishte ekzistua ky element me siguri përkatësisht me një siguri të besueshme ai do të përdorte edhe predha tjera për të kryer veprën penale të privimit nga jeta pa marr parasysh a kishte me qenë vepër e kryer apo në tentativë . Andaj konsideroj se në veprimet e të akuzuarit nuk janë përmbushur elementet e veprës penale të vrasjes në tentativë por ekzistojnë elementet të cilët përfshihen me vepër tjetër penale e që në rastin konkret kishte me qenë rrezikimi i përgjithshëm me pasojat që po dihen tani plagosje. Nga këto rrethana ka propozuar që gjykata pas vlerësimit të ndryshon cilësimin juridikë në drejtim të propozuar dhe ta gjejë përgjegjës për këtë vepër penale, ngase veprimet të cilat i akuzuari i ka pranuar i përkasin kësaj vepre.

I dëmtuari K.B. gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se, i njëjti ditën kritike ka qenë në fitnes përball pompës “... ..” duke ushtruar në ndërkohë kanë hyrë dy persona dhe njëri prej tyre ka filluar me gjuajt me armë ku e ka goditur në bërrylin e dorës së djathtë e ai ka qenë A.H. duke theksuar se i njëjti e ka gjuajtur pas shpine deri sa ai ishte duke ushtruar, i njëjti (i dëmtuari) është tërhequr dhe ka hyrë në zhyeshitore. Po ashtu ka deklaruar se në atë moment nuk janë konfrontuar fizikisht por kanë pasur një problem me datë 28 nëntor ku pas një fjalosje e ka rrahur A.H.1 .

Gjykata në shqyrtimin gjyqësor ka nxjerrë të gjitha provat të nevojshme dhe pas vlerësimit të secilës provë veç e veç dhe në tërësi ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Sa i përket pikës nën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, gjykata në tërësi ka vërtetuar se i akuzuari A.H. me datë 05.12.2015, rreth orës 19:45 min, në Prizren, në rrugën “.....”, me dashje eventuale, ndërmerr veprim të drejtpërdrejt, tenton ta privoj nga jeta K.B. , në atë mënyrë që si pasojë e një mosmarrëveshje të mëhershme të cilën e kishin ndërmjet vete, së bashku me vëllain e tij A.H.1 , pasi hyjnë në lokalitë e fitnesit “.....”, që gjenet pompës së derivateve “... –

.....” dhe pasi e vërej në të dëmtuarin brenda duke bërë ushtrime në vegla, shtënë me armë zjarri – pistoletën e tipit “Ekol Tuna - Zastava”, të kalibrit 8mm, një herë në drejtim të tij, nga një distancë prej 4,40 metra, të cilin e godet në krahun e djathtë – bërryl, me ç’rast i shkakton plagë hyrëse nga depërtimi i predhës së plumbit në krahë, duke i shkakuar lëndime të rënda trupore.

Po ashtu gjykata në tërësi ka vërtetuar gjendjen faktike se, i akuzuari A.H. prej kohës së pa vërtetuar deri me datë, 05.12.2014, në Prizren, mbanë në posedim armën e zjarrit pistoletën e tipit “Ekol Tuna - Zastava”, të kalibrit 8mm, Gas, me nr. serik ET1021714, e dizajnuar edhe për fishek të kalibrit 6.35x15mm, pa autorizim dhe pa leje të organit kompetent, të cilën armë edhe e ka përdorur duke shtënë në të dëmtuarin K.B. .

Sa i përket pikës nën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, për të akuzuarin A.H.1 , për veprën penale, lajmërimi apo kallëzimi i rremë, nga neni 390 par. 3 të KP-së, gjykata në tërësi ka vërtetuar gjendjen faktike se i akuzuari A.H. , me datë 05.12.2015, në Prizren, pas informatës të cilën e kishin pranuar Policia se ka ndodhur një rast i plagosjes me armë zjarri në rr. “.....”, saktësisht në klubin e fitnesit “.....” nga ana e personave të panjohur për policinë, i njëjti paraqitet në polici dhe lajmëron se ai e ka kryer veprën penale të plagosjes me armë, me ç’ rast thotë se vetë ka shtënë në të dëmtuarin K.B., i cili po ashtu rrejshëm ka deklaruar edhe në Prokurori, derisa gjatë shqyrtimit gjyqësor në bazë të provave të proceduara është vërtetuar por edhe i njëjti vetë ka pranuar se ai nuk është kryerës i kësaj vepre por veprën e ka kryer vëllai i tij – akuzuari A.H. .

Ndërkaq, sa i përket veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar e armeve nga neni 374 par 1, të KP-së për të akuzuarin A.H. , gjykata pas procedurës së provave gjeti gjendjen faktike të ndryshme nga aktakuza, të cilën nuk e mbështetnin as edhe vetë provat e akuzës. Gjykata e gjeti këtë gjendje faktike pas analizës së të gjitha provave së bashku në këtë çështje penale dhe të secilës veç e veç, me ç’ rast nuk është provuar që i akuzuari të ketë kryer veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar e armeve nga neni 374 par 1, të KP-së.

Këtë gjendje faktike gjykata e vërtetoi pasi ka administruar këto prova; dëgjimin e dëshmitarëve, F.B. , L.M. , V.M. , si dhe provat e tjera materiale dhe atë; Raporti i balistikës i Agjensisë së Kosovës për Forenzikë nr. AKF/....-.. të datës 21.06.2016, Raporti i qendrës mjekësore emergjente në Prizren, nr. të datës 05.12.2015 për të dëmtuarin K.B. , lista e armeve të konfiskuara nr.-GA-.... e datës 09.12.2015, raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes nga Njësia e forenzikës nga Drejtoria Rajonale e Policisë nr.- KVK-... të datës 06.12.2015, Raporti i rikonstruimit të vendit të ngjarjes i datës 28.07.2016 së bashku me skicën me legjendë dhe fotoalbumin, raportit të Institutit të Mjekësisë Ligjore – ekspertit mjeko-ligjor Dr. F.B. të datës 10.08.2016.

Nga deponimi i dëshmisë së dëshmitarit F.B. , të dhënë gjatë shqyrtimit kryesor, gjykata ka konstatuar për faktin se, dëshmitari është vëllai i të dëmtuarit K.B. dhe se i njëjti ditën kritike ka qenë duke u stërvitur në fitnesin “.....”, i njëjti ka deklaruar se, atë ditë kanë hyrë dy djem në fitnes njeri ka qenë me një shkop bejzbolli e tjetri me armë në dorë ndërkohë që personi i cili e ka pasur armën ka shtënë një herë në drejtim të K.B. . Pastaj K.B. është larguar dhe ka hyrë në zhveshtore i cili ka dal nga aty pasi kanë ikur të akuzuarit. I njëjti ka theksuar se kur i akuzuari

ka gjuajtur me armë, K.B. ka qenë i shtrirë në ushtruese dhe ka qenë me pozitë anash me të akuzuarin.

Nga deponimi i dëshmisë së dëshmitarit L.M. , të dhënë gjatë shqyrtimit kryesor, gjykata ka konstatuar për faktin se, dëshmitari, është pronar i lokalit fitnesit “.....” dhe se ditën kritike i njëjti ka qenë duke punuar në banak të lokalit, ku ndërkohë ka dëgjuar një krismë, pasi ka dalur nga banaku ka parë aty A.H. me një armë në dorë ndërkaq K.B. veç kishte hyrë në zhveshtore dhe nuk e ka parë më herët se si ka ndodhur ngjarja. I njëjti ka theksuar se është marr me personat të cilët kanë sulmuar të cilët kanë qenë tek dera e zhveshtorës duke i mshuar derës me dorë të cilët kanë qëndruar afro 10 sekonda, ku më pas të njëjtit i ka larguar nga aty dhe kanë dalur nga lokali. Pas kësaj e ka parë se i dëmtuari K.B. ka qenë i plagosur në krahun e djathtë ku edhe janë munduar që të ia japin ndihmën e parë.

Nga deponimi i dëshmisë së dëshmitarit V.M. , të dhënë gjatë shqyrtimit kryesor, gjykata ka konstatuar për faktin se, dëshmitari, është trajner i fitnesit dhe ditën kritike në lokalit e njëjti ku ka ndodhur rasti ka qenë duke ushtruar. I njëjti ka deklaruar se ka qenë duke ushtruar në fitnes në pjesën e mbrapme nga vendi ku ka ndodhur ngjarja në distanc rreth 25 – 30 metra dhe se nuk e ka parë se si ka ndodhur ngjarja. Thekson se ka dëgjuar një krismë mirëpo pas pak çastesh kur është afruar tek vendi ku ka ndodhur ngjarja kishte përfunduar të akuzuarit pronari i lokalit i kishte nxjerr jashtë dhe as K.B. nuk e ka parë dhe më pas i është kthyer ushtrimeve të veta.

Nga leximi në listën e armeve të konfiskuara nr.-GA-.... e datës 09.12.2015, gjykata ka vërtetuar faktin se, nga Policia e Kosovës me datë 09.12.2015 është konfiskuar arma – pistoleta “Ekol Tuna” e kalibrit 8mm P.A.K, Zastava, me nr. serik ET-1021714 dhe një karikator i pistoletës.

Nga leximi i Raportit të balistikës i Agjensisë së Kosovës për Forenzikë nr. AKF/....../....-.. të datës 21.06.2016, gjykata ka vërtetuar faktin se, arma – pistoleta e ri dizajnuar e gasit – Ekol Tuna, me mbishkrimin “ZASTAVA”, e kalibrit 8 mm GAS, me nr. serik ET-1021714, e cila është konvertuar - adoptuar (duke i vendosur tytë me vjaska, e punuar me dorë) për fishek të kalibrit 6,35x15 mm, pas ekzaminimi është konstatuar se kjo pistoletë funksionon si armë e zjarrit. Po ashtu një karikator i zbrazët i dizajnuar për këtë pistoletë me kapacitet prej gjashtë fishekësh të kalibrit 8mm, por ky karikator nxen gjithashtu edhe shtatë fishekë të kalibrit 6,35x15 mm .Gjithashtu në bazë të këtij raporti është konstatuar se gëzhoja, pjesë e fishekut 6,35x15 mm, është shkrepur nga arma e lartcekur.

Nga leximi i Raportit të qendrës mjekësore emergjente në Prizren, nr. të datës 05.12.2015 për të dëmtuarin K.B. , gjykata ka vërtetuar faktin se, i dëmtuari K.B. , me datë 05.12.2015, në ora 20:00, është dërguar me auto ambulancë në Emergjencë në Spitalin Rajonal të Prizrenit për shkak të plagosjes në bërrylin e djathtë e cila plagë është shkaktuar nga arma e zjarrit.

Nga Leximi i raportit të Institutit të Mjekësisë Ligjore – ekspertit mjeko-ligjor Dr. F. B. të datës 10.08.2016, gjykata ka vërtetuar faktin se, nga kryerja e ekspertizës për të dëmtuarin K.B. konstatohet që plaga nga arma e zjarrit në bërrylin e dorës së djathtë (predha e mbetur në ashtin e ulnës), e shkaktuar nga veprimi dinamik i predhës, bënë pjesë në dëmtime të rënda trupore.

Nga leximi i raportit të këqyrjes së vendit të ngjarjes nga Njësia e forenzikës të Drejtorisë Rajonale të Policisë nr.- KVK-... të datës 06.12.2015, gjykata ka vërtetuar faktin se, vendi i ngjarjes ndodhet në anën a djathtë të rrugës “.....”, përball “...” , konkretisht te Fitnesi Club “.....”. Fitnesi ndodhet në podrumin e ndërtesës kolektive që hyhet përmes shkalleve nga jashtë. Pas derës hyrëse me xhama ndodhet hapësira e madhe e cila përfshinë pothuajse tërë podrumin e ndërtesës, e cila hapësirë është e mbushur me vegla të ndryshme sportive të vendosura në vende të ndryshme. Në të djathtë të hyrjes ndodhet shanku ngjit me shankun është korridori që ndanë shankun nga zhveshtorja. Në murin e zhveshtorës nga hapësira e palestrës është e vendosur një pasqyre e madhe dhe para kësaj pasqyre janë dy pajisje për ushtrime të gjoksit që një njërën prej tyre dyshohet të ketë qenë duke ushtruar viktimën ngase në këtë vend janë gjetur dëshmitë – një gëzojë e kalibrit të vogël dhe një njollë e kuqe gjaku.

Nga leximi i Raportit të rikonstruimit të vendit të ngjarjes i datës 28.07.2016 së bashku me skicën me legjendë dhe fotoalbumin, gjykata ka vërtetuar faktin se, në fitnesin “.... ..” ish “.....” në rr. “.....” në Prizren, distanca në mes të dëmtuarit K.B. (K) dhe të akuzuarve A.H. dhe A.H.1 (A2A2) pak para se të ndodh gjuajtja me armë ka qenë 3.80m. Distanca në mes të pozitës së të akuzuarve dhe pozitës së të dëmtuarit (K1) pas gjuajtjes ka qenë 4.10m. Distanca mes pikës referuese P1 (qoshi i djathtë i zhveshtorës së meshkujve) dhe pozitës së dëshmitarit L.M. (L) në kohën e gjuajtjes ka qenë 4.40m. Distanca në mes të pikës referuese P1(qoshi i djathtë i zhveshtorës së meshkujve) dhe të dëmtuarit K.B. (K1), pas gjuajtjes ka qenë 1.60m.

Pas dëgjimit të dëshmitarëve, si dhe vlerësimit të provave materiale, gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit A.H. qëndrojnë elementet qenësore që përcaktojnë veprat penale; vrasje në tentativë, nga neni 178 lidhur me nenin 28 të KP-së dhe veprës penale, mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armeve nga neni 374 par. 1 të KP-së. Po ashtu gjykata ka vërtetuar se në veprimet e të akuzuarit A.H. qëndrojnë elementet e veprës penale, lajmërimi apo kallëzimi i rremë, nga neni 390 par. 3 të KP-së, prandaj gjykata të akuzuarit për veprat penale të cekura të akuzuarit i ka shpallë përgjegjës. Ndërkaq, sa i përket të akuzuarit A.H.1 për veprën penale, mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armeve nga neni 374 par. 1 të KP-së, pas administrimit të provave gjykata gjetur se me veprimet e të akuzuarit A.H.1 nuk formohen elementet e kësaj vepre penale prandaj të njëjtin e liroi nga kjo akuzë.

Gjendja faktike është vërtetuar pjesërisht nga mbrojtja e të akuzuarve deklarata e të dëmtuarit dhe dëshmitë e dëshmitarëve të cekur, nga te cilat rrjedh se nuk është kontestues fakti se i dëmtuari K.B. ditën kritike ka qenë duke ushtruar në fitnesin “.....” në Prizren, po ashtu nuk është kontestuar fakti se po në atë fitnes në ditën kritike me datë 05.12.2015 kanë shkuar edhe të akuzuarit A.H. dhe A.H.1 dhe pasi janë takuar me të dëmtuarin K.B. të cilët dhe më herët kanë pasur një konfrontim ndërmjet tyre, në atë moment i akuzuari A.H. e nxjerr pistoletën dhe shtënë në të dëmtuarin K.B. një herë.

Sa i përket pretendimeve të mbrojtësit të të akuzuarit A.H. se, në veprimet e të akuzuarit nuk janë përmbushur elementet e veprës penale të vrasjes në tentativë por ekzistojnë elementet të cilët përfshihen me vepër tjetër penale e që në rastin konkret kishte me qenë rrezikimi i përgjithshëm me pasoja plagosje, gjykata vlerëson se nuk qëndrojnë, sepse, i akuzuari A.H. ka vepruar në mënyrë të vetëdijshme dhe ka kuptuar pasojat që mund të shkaktoheshin me rastin e shkrepjes me armë zjarri duke e venë në rrezik të dëmtuarin, megjithatë nga veprimet e të akuzuarit gjykata vlerëson se i njëjti nuk e ka dëshiruar shkaktimin e pasojave të cilat do të përbënin tiparet e veprës penale të vrasjes. Këtë konstatim gjykata e arsyeton për faktin se i akuzuari A.H. ka mundur ta përfundojë veprën e mbetur në tentativë, i njëjti ka pasur pistoletën në

dorë, e ka pasur të mbushur do të thotë ka pasur edhe pesë fishek në karikator, mirëpo nuk ka shkrepur më shumë.

Kjo gjendje faktike ndaj të akuzuarit A.H., vërtetohet edhe nga rekonstruimi i vendit të ngjarjes, ekspertiza e balistikës si dhe ekspertiza e ekspertit mjeko ligjor Dr.Sci. F.B., nga të cilat rrjedh se i dëmtuari K.B. ka qenë duke ushtruar në fitnesin “.....”, dhe ndërkohë pasi kanë ardhur të akuzuarit A.H. dhe A.H.1, pas një konfrontimi ndërmjet vete i akuzuari A.H. ka shtënë një herë në drejtim të dëmtuarit K.B., dhe plagët të cilat i ka pësuar i dëmtuari K.B. në bërrylin e djathtë i përgjigjen plagëve të shkaktuara nga veprimi dinamikë i predhës nga arma e zjarrit dhe një predhë nga largësia prej 3,80m në drejtim të dëmtuarit i cili ka qenë në këmbë pranë pajisjes së ushtrimeve, dhe se e shtëna ka ardhur nga pozita e të akuzuarit A.H. dhe A.H.1, gjë që në tërësi përputhet edhe me fotodokumentacionin e të cilat janë në përputhshmëri të plotë dhe të ilustruara si prova materiale në fotografit nr. 5, 6 7, 8, 9 dhe 10 ku shihet i dëmtuari K.B. pranë pajisjeve për ushtrime i ulur pastaj në këmbë si dhe pozicioni i të akuzuarve në këmbë para se të ndodhë gjuajtja me armë.

Nga rikonstruimi i vendit të ngjarjes si dhe nga provat e administruara nga ana e gjykatës është gjetur edhe 1 (një) gëzhøjë, dhe nga ekspertiza e kryer nga Raportit të balistikës i Agjensisë së Kosovës për Forenzikë rrjedh se gëzhjoja e kal. 6.35 x 15 mm , është pjesë e fishekut të kal. 6.35x15mm, që i përgjigjet armës së zjarrit – pistoletës e cila është përdorur ditën kritike, ndërsa kjo ekspertizë në tërësi përputhet edhe me deklaraten e vet të akuzuarit A.H. i cili pranon se ka shkrepur me revole të llojit Ekol Tuna, me mbishkrimin “ZASTAVA”, e kalibrit 8 mm GAS, me nr. serik ET-1021714, në drejtim të dëmtuarit K.B. .

Gjykata duke marr parasysh të gjitha këto fakte relevante të vërtetuara në shqyrtimin kryesor, duke administruar të gjitha provat e nxjerrura në procedurën hetimore dhe ato të nxjerrura gjatë shqyrtimit gjyqësor, ka ardhë në përfundim se në veprimet e të akuzuarit A.H. formohen elementet qenësore të veprave penale për të cilat të është shpallur fajtor si në shqiptimet e këtij aktgjykimi, e më parë duke vërtetuar në tërësi edhe përgjegjësinë penale juridike të tij, si dhe konformë nenit 374 paragrafi 3, është konfiskuar arma – tipit “Ekol Tuna - Zastava”, të kalibrit 8mm, Gas, me nr. serik ET1021714, si mjet i kryerjes së veprës penale.

Në anën tjetër, sa i përket të akuzuarit A.H.1 gjykata gjatë administrimit të provave (provat e lart theksuara) dhe pas analizimit të secilës provë veç e veç dhe të ndërlidhura në tersi, është vërtetuar fakti se i akuzuari pas informatës të cilën e kishin pranuar Policia se ka ndodhur një rast i plagosjes me armë zjarri në rr. “.....”, saktësisht në klubin e fitnesit “.....” nga ana e personave të panjohur për policinë, i njëjti paraqitet në polici dhe lajmëron se ai e ka kryer veprën penale të plagosjes me armë, me ç’ rast thotë, se vetë ka shtënë në të dëmtuarin K.B., i cili po ashtu rrejshëm ka deklaruar edhe në Prokurori, derisa gjatë shqyrtimit gjyqësor në bazë të provave të proceduara më lartë me është vërtetuar fakti se kjo vepër penale është kryer nga vëllai i tij, akuzuari A.H. . Prandaj duke pasur parasysh se i akuzuari A.H.1 me datë 09.12.2015 në polici dhe prokurori ka deklaruar - lajmëruar rrejshëm veprën penale kinse ai vetë e ka kryer e që në të vërtet nga provat e administruara në këtë çështje penale si dhe nga vetë deklarata e të akuzuarit A.H.1 i cili në shqyrtimin gjyqësor ka pranuar se ka deklaruar rrejshëm, janë vërtetuar faktet që me veprimet e të akuzuarit A.H.1 formohen të gjitha elementet e veprës penale, lajmërimi apo kallëzimi i rremë, nga neni 390 par. 3 të KP-së. prandaj gjykata të njëjtin e për këtë vepër të njëjtin e shpalli fajtor dhe i shqiptoi dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Ndërkaq, sa i përket veprës penale, mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar e armeve nga neni 374 par 1, të KP-së, gjykata gjatë administrimit të provave (të

lart theksuara) dhe pas analizimit të tyre nuk ka mundur të vërtetoj faktin se i akuzuari A.H.1 ka kryer veprën penale të armëmbajtjes. Këtë duke pasur parasysh faktin se i akuzuari A.H.1 me rastin e paraqitjes së tij në polici ka dorëzuar armën tipit “Ekol Tuna - Zastava”, të kalibrit 8mm, Gas, me nr. serik ET1021714, për të cilën armë në këtë procedurës gjyqësore është vërtetuar se është përdorur nga i akuzuari A.H. me rastin e kryerjes së veprës penale të vrasjes në tentativë dhe i njëjti armë e ka pasur në pronësi dhe në posedim ndërsa i akuzuari A.H.1 të njëjtën armë vetëm e ka dorëzuar në Polici dhe nuk është vërtetuar se më parë ta ketë përdorur apo poseduar, si dhe nuk e ka ditur se vëllai i tij A.H. posedon këtë armë. Prandaj nga këto rrethana gjykata vlerëson se me veprimet e të akuzuarit A.H.1 nuk formohen elementet e veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar e armeve nga neni 374 par 1, të KP-së, sepse, për të ekzistuar kjo vepër nuk mund të kuptohet çdo rast kur një person i caktuar ndodhet në posedim faktik të armës, për të cilën nuk ka leje të lëshuar nga organi kompetent, por me këtë duhet kuptuar një raport i tillë i kryesit ndaj armës nga i cili manifestohet një raport i caktuar i pushtetit të kryesit ndaj një objekti (arme) të tillë, përkatësisht ai armën duhet ta mbaj si të tijën. Prandaj nga këto rrethana dhe arsye gjykata të akuzuarin A.H.1 e liron nga akuza për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar e armeve nga neni 374 par 1, të KP-së.

Gjykata duke u mbështetur në provat e administruara hudhi poshtë pjesën e mbrojtjes së të akuzuarit A.H. se në rastin e shkrepjes së armës të ketë qenë i akuzuari i kërcënuar nga i dëmtuari, me që asnjëri nga dëshmitarët F.B., L.M. dhe V.M. që kanë qenë prezent, gjatë deklarimeve të tyre në asnjë rast nuk kanë dëgjuar se ka pasur kërcënime nga njëra palë apo tjetra përveç se pas shkrepjes me armë, gjykata në bazë të provave të proceduara, fakteve dhe rrethanave të vërtetuara gjatë gjykimit gjeti se A.H. ka shkruar që të hakmerret për vëllain e tij A.H.1 i cili ishte rrahur më parë me të dëmtuarin. Fakti se ka shkrepur vetëm një herë në të dëmtuarin fletë më së miri se ai ka vepruar me dashje eventuale në rastin konkret pra ishte i përgatitur dhe i armatosur, ka pasur vetëdije se shkrepja me armë mund të shkaktoj pasojën e vrasjes me të cilën është pajtuar, dhe në këtë rast edhe pse ka pasur plumba tjerë dhe nuk ka shtënë, kjo falë ikjes së të dëmtuarit dhe fshehjes së tij, prandaj vepra penale ka ngelë në tentativë.

Gjatë marrjes së vendimit mbi dënimin kundër të akuzuarve A.H. dhe A.H.1, e duke u nisur nga shkalla e rrezikshmërisë shoqërore të veprave të kryera dhe duke vlerësuar shkallën e përgjegjësisë penale juridike ndaj të akuzuarve, në kuptim të dispozitës së nenit 73 të KP-së, gjykata vlerësoi edhe vërtetoi të gjitha rrethanat e rëndësishme për caktimin e lartësisë së dënimit, si rrethana rënduese për të akuzuarin A.H. gjykata ka vlerësuar peshën dhe rrezikshmërinë shoqërore të veprave penale të kryera, ndërkaq si rrethana lehtësuese për të akuzuarit ka vlerësuar faktin se, të njëjtit kanë shprehur keqardhje për rastin e ndodhur si dhe pendimin e thellë të tyre për veprimet të cilat i kanë ndërmarrë po ashtu edhe premtimin e tyre se në të ardhmen nuk do të përsërisin veprime të tilla, faktin se pas konfliktit me të dëmtuarin nuk kanë pasur asnjëherë ndonjë problem, prandaj gjykata në prezencën e këtyre rrethanave të vërtetuara të akuzuarve iu shqiptoj dënimet si në shqiptim të këtij aktgjykimi, me bindje se dënimi unik i shqiptuar ndaj të akuzuarit A.H. në kohëzgjatje prej një viti e tetë muajve në të cilën dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim si dhe dënim i shqiptuar ndaj të akuzuarit A.H.1 në kohëzgjatje prej dy muajve në të cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim, të njëjtat iu janë shqiptuar me bindje se dënimet e këtyre të shqiptuara mund të ndikojnë pozitivisht tek të akuzuarit dhe në rrethin ku ata jetojnë, me bindje se të akuzuarit në të ardhmen do të përmbahen në kryerjen e veprave penale të këtij lloji.

Vendimi mbi udhëzimin në kontest të rregullt civil juridik për realizimin e kërkesës pasurore juridike, është marrur në harmoni me nenin 463 të KPP-së.

Vendimi mbi dënimin plotësues është marr në kuptim 374 paragrafi 3 lidhur me nenin 62 dhe 69 të KP-së

Vendimi mbi paushallin gjyqësor u muar në kuptim të nenit 450 par.2.6 të KPP-së,

Me sa u tha u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi, e në mbështetje të nenit 364 dhe 365 të KPP-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
-Departamenti i Krimeve të Rënda-
PKR.nr.51/2016, të datës 14.12.2016

Bashkëpunëtori profesional
Shahadin Destani

Kryetari i trupit gjykues
Xhevdet Elshani

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 dite, prej ditës së marrjes së të njëjtit. Ankesa i ushtrohet Gjykatës Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet Gjykatës Themelore në Prizren.